REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 1252/4 prot.

Tiranë, më 29.9.2026

V E N D I M
Nr 32, datë 29.9.2026

PËR
MIRATIMIN E PLANEVE MËSIMORE DHE PROGRAMEVE TË LËNDËVE TË PROGRAMIT TË FORMIMIT FILLESTAR PËR KANDIDATËT PËR MAGJISTRATË DHE AVOKAT SHTETI PËR VITIN AKADEMIK 2026-2027

Në mbështetje të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", nenet 248, 263; ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit" i ndryshuar, si dhe në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, i mbledhur më datë 29.9.2026,

V E N D O S I:

1. Të miratojë planet mësimore të vitit të parë dhe vitit të dytë për kandidatët për magjistratë dhe avokat shteti, si dhe planin mësimor të vitit të tretë për kandidatët për magjistratë, sipas materialit bashkëngjitur, pjesë e pandarë e këtij vendimi.
2. Të miratojë programet mësimore të lëndëve të vitit të parë dhe vitit të dytë për kandidatët për magjistratë dhe avokat shteti në Programin e Formimit Fillestar për vitin akademik 2026-2027, sipas materialit bashkëngjitur, pjesë e pandarë e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.